



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.89

21 korrik

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.397, datë 11.7.2007	Për një përjashtim nga vendimi nr.244, datë 7.3.2007 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007”, të ndryshuar.....	2593
Udhëzim i MF nr.12, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në udhëzimin nr.6, datë 22.2.2006 “Mbi administrimin dhe detyrimet tatimore për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”	2593
Urdhër i MBUMK nr.234, datë 9.7.2007	Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së “Kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara, pasuri shtetërore” dhe të “Formularit tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore”	2596
Urdhër i MTKRS nr.448, datë 5.7.2007	Për ripërtëritjen e licencës së Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj, “Albautor”	2601
Urdhër i METE nr.496, datë 4.7.2007	Për përcaktimin e fondit të ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve në lojërat e fatit.....	2603
Urdhër i MPPTT&MB nr.4211/2, datë 12.7.2007	Për një ndryshim në urdhrin nr.4211, datë 7.6.2007 “Mbi masat për pezullimin e përkohshëm të qarkullimit të mjeteve të transportit të mallrave, gjatë sezonit turistik”	2604

VENDIM
Nr.397, datë 11.7.2007

PËR NJË PËRJASHTIM NGA VENDIMI NR.244, DATË 7.3.2007 I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE
INSTITUCIONET QENDRORE, PËR VITIN 2007”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshihet për Akademinë e Shkencave afatet “janar - 31 maj” dhe “1 qershor - dhjetor”, të përcaktuara në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministratë dhe institucionet qendrore, për vitin 2007”, të ndryshuar, bëhen “janar – 31 gusht” dhe “1 shtator - dhjetor”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.12, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.6, DATË 22.2.2006 “MBI ADMINISTRIMIN
DHE DETYRIMET TATIMORE PËR LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE
HIPODROMET”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Formulari i deklarimit dhe pagesës së lojërave të fatit, i cili i bashkëngjitet udhëzimit nr.6, datë 22.2.2006 “Mbi administrimin dhe detyrimet tatimore për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, zëvendësohet me modelin bashkëlidhur, pjesë përbërëse e udhëzimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode

**FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESES SE TATIMIT
MBI LOJRAT E FATIT**



Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):

(3)

Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:

(4)

Emri Mbiemri i Personit Fizik:

(5)

Adresa:

(6)

Qyteti/Komuna/Rrethi:

(7)

Numri Telefonit:

Ligjimetimi nese informacioni i magesperim eshte jo i plote dhe ka ndryshore

(8) ☐ Pa veprimtari

(9/10) Lojra aritmetike, bingo brenda salles, rreth kat I

(11/12) Lojra aritmetike, bingo brenda salles, rreth kat II

(13/14) Lojra aritmetike, bingo brenda salles, rreth kat III

(15) Bastet sportive, kuota fikse per shoqerine

(16/17) Bastet sportive, pika ne rreth kat.I

(18/19) Bastet sportive, pika ne rreth kat.II

(20/21) Bastet sportive, pika ne rreth kat.III

(22/23) Lojra elektronike me fitim ne cast, rreth kat I

(24/25) Lojra elektronike me fitim ne cast, rreth kat II

(26/27) Lojra elektronike me fitim ne cast, rreth kat III

(28/29) Kazino, tavolina te lojes rulete

(30/31) Kazino, tavolina te lojrave me letra dhe zure

(32/33) Kazino, lojra elektronike dhe slot makina me fitim ne cast

(34) Hipodromet,kuota fikse per shoqerine

(35/36) Hipodromet,pika basti

(37/38) Hipodromet, lojra elektronike me fitim ne cast

(39/40) Lojra aritmetike, bingo qe nuk zhvillohet brenda sallave

(41/42) Lojra sportive,konkurset e parashikimeve sportive

(43/44) Llotari kombetare, llotari me short

(45/46) Llotari kombetare, llotari e castit

(47/48) Lojra aritmetike, keno

(49) Lojra promocionale

(50) Lojra elektronike me disa pozicione

(51) Tatimi per tu paguar

(52) Denime / interesa per vonesa

(53) TOTALI PER TU PAGUAR

Nr Detyrimi

01	01
02	02
03	03
04	04
05	05
06	06
07	07
08	08
09	09
10	10
11	11
12	12
13	13
14	14
15	15
16	16
17	17
18	18
19	19
20	20
21	21
22	22
23	23
24	24
25	25
26	26
27	27
28	28
29	29
30	30
31	31
32	32
33	33
34	34
35	35
36	36
37	37
38	38

Qarkullimi Detyrimi

01	01
02	02
03	03
04	04
05	05
06	06
07	07
08	08
09	09
10	10
11	11
12	12
13	13
14	14
15	15
16	16
17	17
18	18
19	19
20	20
21	21
22	22
23	23
24	24
25	25
26	26
27	27
28	28
29	29
30	30
31	31
32	32
33	33
34	34
35	35
36	36
37	37
38	38

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem Deklaroj nen pergjegjesi me time qe informacioni i magesperim eshte i plote dhe i sakte

Vetem per perdorim zyrtar

PAGESA

☐ Leke

☐ Xhirim

☐ Cek

☐ Te tjera:.....

SHUMA E PAGUAR:

Data, Vendi Banka dhe nenshkrimi i neqanessit te bankes

Original - Zyrtar, 101 nese
Kopje - Patelet, 1 Tatueshem

Udhëzues për mënyrën e plotësimit të formularit

1. **Numri serial** gjenerohet nga Dega e Tatimeve dhe shërben për të azhuruar regjistrimet kur paraqitet deklarata
2. **Periodha Tatimore** është mujore, ose pjesë e muajit në rast mbyllje të aktivitetit.
3. **Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshem (NIPT)** është numri i dhënë nga Dega e Tatimeve dhe që identifikon personin e tatueshem në të gjitha marrëdhëniet me Degen e Tatimeve
4. **Emri Tregtar i Personit të Tatueshem** është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it
5. **Emri, Mbiemri i Personit Fizik** vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një person fizik dhe nuk ka emër tregtar
6. **Adresa** tregohet për vendin kryesor të ushritimit të veprimtarisë. Kjo adresë është treguar edhe në certifikatën e NIPT-it
7. **Numri i Telefonit** (nëse ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushritimit të veprimtarisë ekonomike
8. **Pa veprimtari** zgjidhet vetëm nëse nuk është kryer aktivitet gjatë periudhës për të cilën bëhet deklarimi. Vendosni oje kryq në kutinë 8, firmoseni deklaratën dhe paraqiteni në barke.
- 9/10. **Numri i sallave** në rreth të kategorisë I x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë I
- 11/12. **Numri i sallave** në rreth të kategorisë II x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë II
- 13/14. **Numri i sallave** në rreth të kategorisë III x kuota fikse për sallë në rreth të kategorisë III
15. **Kuota fikse sipas ligjit**
- 16/17. **Numri i pikave** në rreth të kategorisë I x kuota fikse për pikë në rreth të kategorisë I
- 18/19. **Numri i pikave** në rreth të kategorisë II x kuota fikse për pikë në rreth të kategorisë II
- 20/21. **Numri i pikave** në rreth të kategorisë III x kuota fikse për pikë në rreth të kategorisë III
- 22/23. **Numri i makinave/kompjuterave** në rreth të kat. I x kuota fikse për pikë në rreth të kat. I
- 24/25. **Numri i makinave/kompjuterave** në rreth të kat. II x kuota fikse për pikë në rreth të kat. II
- 26/27. **Numri i makinave/kompjuterave** në rreth të kat. III x kuota fikse për pikë në rreth të kat. III
- 28/29. **Numri i tavolinave** x taksa mujore
- 30/31. **Numri i tavolinave** x taksa mujore
- 32/33. **Numri i makinave** x taksa mujore
34. **Kuota fikse sipas ligjit**
- 35/36. **Numri i pikave** x taksa mujore
- 37/38. **Numri i makinave** x taksa mujore
- 39/40. **Qarkullimi** x 20%
- 41/42. **Qarkullimi** x 20%
- 43/44. **Qarkullimi** x 20%
- 45/46. **Qarkullimi** x 20%
- 47/48. **Qarkullimi** x 20%
49. **Detyrimi**
50. **Detyrimi** (lojrat elektronike me disa pozicione duhet të hiqen brenda 6 muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit 9744 datë 28.05.2007)
51. **Tatimi për të paguar** është shuma e kutive të kolonës detyrimi.
(pra 51 = 10+12+14+15+17+19+21+23+25+27+29+31+33+34+36+38+40+42+44+46+48+49+50)
52. **Denime/interesa për vonesa** janë denimet dhe interesat për vonesat në deklaratë ose pagesë që mund të llogariten paraprakisht dhe që mund të paguhen me deklaratën
53. **Totali për të paguar** është shuma e tatimit për të paguar (kutia 51) me denimet dhe interesat e llogaritura me deklaratën (kutia 52). (53=51+52)

URDHËR
Nr.234, datë 9.7.2007

**PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES DHE FORMËS SË “KONTRATËS TIP PËR DHËNIEN
ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE, TË PANDARA, PASURI SHTETËRORE” DHE TË
“FORMULARIT TIP TË KËRKESËS PËR QIRAMARRJE
TË TOKËS BUJQËSORE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 8 të ligjit nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, të vendimit nr.531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave “Për tokat bujqësore të pandara”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr.3, datë 16.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”,

URDHËROJ:

1. Përmbajtja dhe forma e “Kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore, të pandara” të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëngjitet këtij urdhri.

2. Përmbajtja dhe forma e “Formularit tip të kërkesës për qiramarrje të tokës bujqësore” të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëngjitet urdhrit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Jemin GJANA

Lidhja nr.1

KONTRATË TIP

PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE, TË PANDARË, PASURI SHTETËRORE

Kjo kontratë lidhet sot, në datën _____ ndërmjet palëve:

Komuna/bashkia _____, përfaqësuar nga kryetari i komunës/bashkisë,

Z. _____ (më poshtë do të quhet “Qiradhënës”)

dhe

Z. _____ (identiteti i plotë i personit fizik ose juridik)

Objekti: Dhënie me qira e tokës bujqësore, të pandarë, pasuri shtetërore, që identifikohet me këta tregues:

- Vendndodhja (fshati _____ komuna _____ rrethi _____)

- Sipërfaqe që jepen me qira gjithsej _____ ha, me:

numrat përkatës kadastralë:

nr. kadastral _____ sip. _____ ha, kategoria _____

nr. kadastral _____ sip. _____ ha, kategoria _____

.....
.....

numrat përkatës të pasurisë (kur është kryer regjistrimi nga ZVRPP)

nr. _____, sip. _____ ha, nr. _____ sip. _____ ha, nr. _____ sip. _____ ha

.....
.....

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Komuna/bashkia _____, në bazë të vendimit të bordit të dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara (BQTBP),

nr. _____, datë _____, i jep me qira, Z. _____

(identiteti i plotë i personit fizik ose juridik) _____, tokën bujqësore të identifikuar më sipër (objekti).

2. Palët kontraktuese e hartojnë dhe e lidhin këtë kontratë në përputhje me ligjin nr.8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, vendimit nr.531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826 deri 841 të tij dhe ligjin nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, si dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore, që kanë si objekt tokën bujqësore.

DISPOZITA TË VEÇANTA

Qiradhënësi merr përsipër:

1. në bazë të vendimit të BQTBP-së, i dorëzon sipërfaqen e tokës, objekt i kësaj kontrate sipas zërave ekzistues kadastralë, në sipërfaqe totale prej _____ ha;

Kontratës i bashkëngjitet planimetria përkatëse e tokës së dhënë me qira.

2. t'i garantojë qiramarrësit përfshirjen e sipërfaqes së tokës në programet e zhvillimit rajonal me kushte të barabarta me të gjitha pronat tokë bujqësore që posedohen nga pronarët e tjerë të ligjshëm;

3. t'i garantojë qiramarrësit pagimin e detyrimit dhe taksave financiare që rëndojnë mbi tokën bujqësore, për të gjithë kohën që kontrata është në fuqi;

4. të ushtrojë kontrolle periodike mbi gjendjen e fondit të tokës bujqësore, zbatimin e dispozitave të ligjit për mbrojtjen e tokës. Para fillimit të kontrollit të njoftojë qiramarrësin dhe në fund të çdo kontrolli t'i dorëzojë procesverbalin me detyrat konkrete dhe të bazuara ligjore;

5. në çdo rast, kur konstaton se qiramarrësi e ka dhënë tokën me nënqira pa pëlqimin e tij, ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës.

Qiramarrësi merr përsipër:

1. pagimin e qirasë për qiramarrje të tokës sipas vendimit të BQTBP-së dhe të pasqyruar në këtë kontratë;

Pagesa e qirasë kryhet çdo fund tremujori, në masën 25% të shumës së qirasë vjetore.

2. t'i sigurojë qiradhënësit se:

a) toka do të përdoret vetëm për veprimtari bujqësore dhe blegtorale;

b) do të ruhet kategorizimi i resursit "tokë bujqësore";

c) do të zbatohet një praktikë të mirë bujqësore të përcaktuar në nenin 16 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore";

d) toka do të shfrytëzohet mbi të drejtën e përcaktuar në nenin 17 të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore";

e) do të sigurojë të gjithë bazën materiale dhe infrastrukturën për kryerjen e veprimtarisë bujqësore e blegtorale mbi tokën bujqësore;

ë) mosdhënien me nënqira të tokës bujqësore, pa marrë pëlqimin e qiradhënësit me shkrim.

DETYRAT E PËRBASHKËTA TË TË DY PALËVE

1. Pretendimet e njëres palë për ndryshim të kushteve të kontratës, i paraqiten palës tjetër 180 ditë para se të kërkohej zbatimi i veprimit të kërkuar.

2. Kalimi i pjesshëm ose i plotë i tokës bujqësore të dhënë me qira në tokë urbane sipas miratimit të KRRTRSH-së, nuk mund të bëhet më shpejt se një vit nga koha e marrjes së vendimit. Në këtë rast qiradhënësi detyrohet të kompensojë qiramarrësin për shpenzimet e kryera në përputhje të dispozitave përkatëse të Kodit Civil dhe të ligjeve të tjera të veçanta.

Afati i qirasë: Fillon (data, muaji, viti)_____ dhe mbaron (data, muaji, viti)_____.

SANKSIONE

1. Qiradhënësi paguan gjobë 1% të çmimit të qiradhënies për çdo ditë vonesë në dorëzimin e tokës, duke filluar nga data e përcaktuar në procesverbal për dorëzimin e tokës dhe të shënuar në këtë kontratë.

2. Qiramarrësi paguan gjobë 1% të detyrimit për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë së përcaktuar në kushtet e kësaj kontrate.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Ndërmjet palëve, çdo mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e detyrimeve ose interpretimin e kushteve të kësaj kontrate, në rast se nuk zgjidhet me mirëkuptim, çështja i paraqitet për gjykim gjykatës së rrethit, në juridiksion të të cilit ndodhet toka bujqësore.

Kjo kontratë bëhet në 4 kopje me vlerë të barabartë.

PËR PALËT KONTRAKTUESE

Qiradhënësi

Qiramarrësi

()

()

Lidhja nr.2

FORMULARI TIP I KËRKESËS PËR QIRAMARRJE TË TOKËS BUJQËSORE

1. Vendndodhja e tokës bujqësore që kërkohet të merret me qira:

- Komuna/ bashkia _____

- Fshati _____

2. Sipërfaqja që kërkohet të merret me qira:

- Gjithsej _____ ha

Me numra kadastralë:

Nr. _____ ha

Nr. _____ ha

Nr. _____ ha

.....

3. Kohëzgjatja e mbajtjes së tokës me qira:

fillon: (datë), (muaji), (viti) _____

mbaron (datë), (muaji), (viti) _____

4. Veprimtaria bujqësore, blegtorale etj. që do të zhvillohet mbi sipërfaqen e kërkuar për qiramarrje:

Kultivimi (kulturat bujqësore) _____ ha

_____ ha

_____ ha

_____ ha

b) Mbarështim (lloji i gjësë së gjallë) _____ krerë

_____ krerë

_____ krerë

_____ krerë

c) Tjetër veprimtari : _____

5. Kërkuesi paraqet garanci financiare (dokument bankar)

- Institucioni _____

- Shuma lekë/euro _____

6. Propozimi i nivelit të çmimit të qiramarrjes për njësi (ha) për një vit që ofron kërkuesi i qiramarrjes së tokës

_____ lekë/ha në një vit kalendarik

Nënshkruesi

Emri, mbiemri i personit fizik (juridik) _____

Emri i firmës, institucionit _____
(sipas regjistrimit në gjykatë)

Vula _____

Adresë e plotë _____

Data _____

URDHËR
Nr.448, datë 5.7.2007

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV
TË SË DREJTËS SË AUTORIT NË FUSHËN E MUZIKËS DHE REGJISTRIMEVE
MEKANIKE TË SAJ, “ALBAUTOR”**

Duke marrë parasysh dokumentet e mëposhtme, bashkëlidhur:

a) kërkesën dhe dosjen me dokumentacionin e Agjencisë “Albautor” për ripërtëritjen e licencës;

b) propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, nr.163 prot., datë 22.6.2007 për licencimin e kësaj agjencie në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj;

c) vlerësimin e Drejtorisë së Hartimit dhe Përafrimit të Legjislacionit dhe Shërbimeve Juridike të MTKRS, mbi ligjshmërinë e kërkesës dhe dosjes;

konstatoj se, në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, është kompetencë e Ministrit miratimi i ripërtëritjes së licencës së kësaj agjencie në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 124 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 108, pika 1, dhe 109, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.9380 datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”,

URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj, “ALBAUTOR”.

2. Afati i licencës është tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

3. Urdhri i Ministrit nr.66, datë 30.3.2004 revokohet.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Ylli Pango



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT
MINISTRI

LIÇENCË

Nr. 1, datë 05/07/2007

Në mbështetje të ligjit nr. 9380, dt 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të" dhe V.K.M nr. 232, datë 19.04.2006, "për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit" (ZSHDA), mbasi konstatoi se dokumentacioni i paracituar është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

VENDOSI:

Të licensojë subjektin "Albautor", si Agjensi e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorit, për degën e artit: "Muzika dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësive artistike".
Njohur si person juridik me Vendim të Gjykatës së Tiranës, me nr.587/1 datë 15.07.2005.
Person i tatueshëm me nr. NPTJ81512003D, me seli: Rruga "Sami Frashëri", pall 20/1; shk 1;ap 1, Tiranë.
Drejtor i Përgjithshëm : z.Neshat Tozaj.

Licenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tri) vjeçare nga hyrja në fuqi e saj.
Kjo licenca hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare
Licenca duhet të ekspozohet në zyrat e agjensisë.

MINISTRI
YLLI PANGO

URDHËR
Nr.496, datë 4.7.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.238, datë 13.4.2001 “Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar

URDHËROJ:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1. Për lojërat aritmetike

a) Për Bingo, fondi i ngurtësimit për shoqërinë të përcaktohet sipas kategorizimit të qyteteve:

- Për qytetet e kategorisë së I-rë (Tiranë dhe Durrës), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së II-të (Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat dhe Kavajë), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së III-të (të gjitha qytetet e tjera), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

- Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

b) Për Keno, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

c) Për lojërat aritmetike, që zhvillohen për pjesëmarrës jashtë sallave, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

2. Për lojërat e fatit sportive

a) Kategoria “Basti”, organizatori të garantojë për çdo lojë fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

b) Kategoria “Konkurs për parashikimet sportive”, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

3. Për lotaritë

a) Lotari me shorte, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

b) Lotari të çastit, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për çdo lotari (leje) të organizuar. Ky fond do të çngurtësohet vetëm pas përfundimit të çdo lotarie (loje).

4. Lojërat elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Licencave dhe e Menaxhimit të Kontratave, Sektori i Lojërave të Fatit.

Urdhri nr.151, datë 6.3.2007 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli**

URDHËR
Nr.4211/2, datë 12.7.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.4211, DATË 7.6.2007 “MBI MASAT PËR
PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË QARKULLIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT
TË MALLRAVE, GJATË SEZONIT TURISTIK”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministri i Brendshëm

URDHËROJNË:

Pika 2 e urdhrit nr.4211, datë 7.6.2007 ndryshon si më poshtë:

2. Pezullimi i qarkullimit të bëhet në segmentet rrugore kombëtare, si:

a) Shkodër-Velipojë,

b) Vlorë-Himarë-Sarandë-Butrint.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

i.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii.	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi.	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

TREGUES LEGJISLACIONI

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 19.7.2007
Doli nga shtypi më 21.7.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë